

**VENDIM**  
**Nr. 94, datë 6.10.2014**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOMP. ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “HURDHAS 1”, “HURDHAS  
2” DHE “HURDHAS 3”, ME FUQI TOTALE**

**4.21 MW**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pikat 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Komp.Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga Hec-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Komp.Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në: nenin 9, pika 1 (formatin e aplikimit); nenin 9, pika 2 (dokumentacionin juridik, administrator dhe pronësor); nenin 9, pika 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal ) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës të përcaktuara në: nenin 9, pika 4.1.1 (Të dhëna specifike për HEC); neni 9, pika 4.1.2 (Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (Dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (Dokumentacioni tekniko-ekonomik); neni 9, pika 4.1.5.

(Leje nga institucione te tjera) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Komp.Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike HEC-et “Hurdhas 1” me fuqi 1,71 MW, “Hurdhas 2” me fuqi 1,3 MW dhe “Hurdhas 3” me fuqi 1,2 MW, me fuqi totale 4.21 MW për një afat 30- vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**